

SYLLABUS: Kontabilitet i Kostos

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI EKONOMIK
Titulli i lëndës:	Bazat e kontabilitetit të kostos
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Semestri 4 (Viti i II-të)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës	Skender Ahmeti
Detajet kontaktuese:	skender.ahmeti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Bazat e kontabilitetit të kostos shqyrton konceptet dhe procedurat që i nënshtrohen zhvillimit të një sistemi të kontabilitetit për vendimet menaxheriale, kontrollin dhe raportimin e performancës. Temat përfshijnë klasifikimin dhe sjelljen e kostos, matjen e kostos dhe kontrollin e kostos; analizën e kostos dhe të vëllimit; përcaktimin e kostos së materialit, punës dhe analizën e kostove të tërhorta, përcaktimin e SEP-it, kalkulimin e kostos për porosinë, kalkulimin e kokstos së proceseve, kostot e bazuara në aktivitete; përllogaritjen e kostos së inventarit, menaxhimit të kostosve të ngjashme. Programi përfundon me njoftimin e përdorimit të kontabilitetit të menaxhmentit në mbështetjen e vendimmarrjes.
Qëllimet e lëndës	Bazat e kontabilitetit të kostos është ndarë nga kontabiliteti i përgjithshëm financiar i cili rregullohet sipas SNRF-ve dhe qëllim kryesor ka përgatitjen e pasqyrave financiare. Qëllimi primar i kontabilitetit të kostos është të raportojë, analizojë dhe udhëheqë drejt kontrollit të brendshëm të kostove dhe eficiencës së biznesit. Kontabiliteti i kostos është sistem i analizave operacionale për menaxhmentin. Zakonisht, objektivi më i thjeshtë dhe më i rëndësishëm i kontabilitetit të kostos është përcaktimi i çmimit të shitjes. Në këtë mënyrë, studentët do të mësohen të kalkulojnë kostot bazike për përcaktimin e një çmimi kushtues dhe atij shitës të çfarëdo produkti që prodhohet apo shërbimi që kryhet. Objektivi i dytë ka të bëjë me kontrollin e kostove. Kompanitë dëshirojnë të jenë në gjendje të harxhojnë më pak nga inputet e tyre dhe të fitojnë më shumë nga outputet e tyre. Kontabiliteti i kostos mund të shfrytëzohet për të identifikuar inefficiencën e mundshme apo fushat e përmirësimit të domosdoshëm për të kontrolluar kostot. Kjo mund të merr formën e kontrollit buxhetor, përllogarirjes standarde apo menaxhimit të inventarit. Bazat e kontabilitetit të kostos mund të kontribuojë për përgatitjen e pasqyrave financiare, një fushë e rezervuar për kontabilitetin financiar. Çmimet dhe informacionet e zhvilluara dhe të studiuara përmes

	kontabilitetit të kostos janë të dëshirueshme për të bërë më të lehtë gurbullimin e informacioneve për qëllime të kontabilitetit financiar.																				
Rezultatet e pritura të nxënies	Në përfundim të ciklit të ligjëratave nga kjo lëndë, studentët duhet të jenë të aftë: - Të kuptojnë rëndësinë e kostove ne afarizmin bashkëkohor të kompanive prodhuese; - Të analizojnë drejt llojet dhe klasifikimi i kostove; - Të jenë në gjendje të përdorë teknika të matematikës ekonomike për analizat dhe shqyrtimin e të dhënave mbi kostot; - T'i aplikoj drejtë teknikat e kontabilitetit të kostos; - Të bëjnë alokimin e drejtë të kostove indirekte të departamenteve shërbyese tek ato prodhuese, - Të bëjnë alokimin e drejtë të kostove të produkteve të lidhura dhe nënprodukteve etj.																				
Kontributi në ngarkesën e studentit																					
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej																		
Ligjërata	2	15	30																		
Ushtrime teorike	1	15	15																		
Punë praktike	-	-	-																		
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	2	10	20																		
Ushtrime në teren																					
Kollokviume, seminare	2	2	4																		
Koha e studimit vetanak të studentit	2	10	20																		
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10																		
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	1	1																		
Projekte, prezantime			-																		
Totali			100																		
Metodologjia e mësimëdhënies	Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Poashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre. Natyrisht, paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literature relevante të lëndës.																				
Metodat e vlerësimit	Vlerësimi: <table><tr><td>Testi i parë</td><td>35%</td></tr><tr><td>Testi final</td><td>35%</td></tr><tr><td>Detyrat e rastit studimor</td><td>15%</td></tr><tr><td>Detyrat e shtëpisë</td><td>15%</td></tr><tr><td>Totali</td><td>100%</td></tr></table> Shkallët e notave: <table><tr><td>91-100%</td><td>- nota 10 (dhjetë)</td></tr><tr><td>81-90%</td><td>- nota 9 (nëntë)</td></tr><tr><td>71-80%</td><td>- nota 8 (tetë)</td></tr><tr><td>61-70%</td><td>- nota 7 (shtatë)</td></tr></table>			Testi i parë	35%	Testi final	35%	Detyrat e rastit studimor	15%	Detyrat e shtëpisë	15%	Totali	100%	91-100%	- nota 10 (dhjetë)	81-90%	- nota 9 (nëntë)	71-80%	- nota 8 (tetë)	61-70%	- nota 7 (shtatë)
Testi i parë	35%																				
Testi final	35%																				
Detyrat e rastit studimor	15%																				
Detyrat e shtëpisë	15%																				
Totali	100%																				
91-100%	- nota 10 (dhjetë)																				
81-90%	- nota 9 (nëntë)																				
71-80%	- nota 8 (tetë)																				
61-70%	- nota 7 (shtatë)																				

		51-60% - nota 6 (gjashtë)	
		50 - me pak - nota 5 (pesë)	

Literatura

Literatura bazë:	1. Prof.dr. Skender Ahmeti: “Kontabiliteti i kostos” Prishtinë, 2018.
Literatura shtesë:	1. Hansen&Mowen: “Menaxhimi i kostos: Kontabilitet dhe kontroll” – botim i përkthyer, 2009 2. Horngren, Datar, Rajan: “Cost Accounting”, Ed.15, USA, 2015

Plani i dizajnuar i mësimi

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e 1-rë:	Përshkrimi (prezantimi) i lëndës
Java e 2-të:	Kontabiliteti i kostos në mjedisin biznesor
Java e 3-të:	Rrjedha e kostove organizative
Java e 4-të:	Teknikat e kontabilitetit të kostos
Java e 5-të:	Kontabiliteti për material, punë dhe kosto të tërthorta të prodhimit
Java e 6-të:	Akumulimi dhe alokimi i kostove
Java e 7-të:	Testi i parë
Java e 8-të:	Metodat e kontabilitetit të kostos
Java e 9-të:	Kalkulimi i kostove për porositë
Java e 10-të:	Kalkulimi i kostove të proceseve
Java e 11-të:	Metoda ABC dhe analiza e profitabilitetit
Java e 12-të:	Alokimi i kostove të departamenteve mbështetëse
Java e 13-të:	Alokimi i kostove të produkteve të lidhura
Java e 14-të:	Njësitë me defekte, njësitë e ripërpunuara dhe skrap
Java e 15-të:	Testi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t’i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç’kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.